



Pranuar / Dorezuar Priljepleni/Prodato Received/Delivered	22.06.2023	3 viti fishat Year	
Organ /Mjesia Organ /Jedinstva Org /Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtetja e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHICK	4884/2023		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.757/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtare si dhe Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës A.nr.757/2023 të datës 18.05.2023 të parashtruar nga ankuesi me adrese banimi nga Komuna e Lipjanit, kundër organit të punësimit Shërbime Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.06.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.757/2023 të datës 18.05.2023 të parashtruar nga ankuesi

MBETET NË FUQI, përgjigja në kërkesë me numër protokoli 499, e datës 20.04.2023 e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 18.05.2023, me numër protokoli 4331/2023, ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes në kërkesë me numër protokoli 499, e datës 20.04.2023, të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 22.05.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë përmes e-mailit në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ndërsa Shërbimi Korrektues i Kosovës, me datë 25.05.2023 ka dërguar përgjigjen në ankesën tek Këshilli.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. Nr. 157/2023 me numër të protokollit 4331/2023 të datës 18.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 30.01.2023; Përgjigje në kërkesë e datës 20.04.2023, me numër protokollit 499; Kërkesë e datës 28.03.2023; Kontratës e punës e datës 11.06.2020; Akt Emërimi i datës 13.02.2020; e- maili i datës 14.03.2023; e- maili i datës 18.03.2023.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës del se ankuesi në bazë të Akt Emërimit të datës 13.02.2020, mbanë pozitën "Zyrtar Korrektues", në Qendrën Korrektues Lipjan, dhe mbi bazën e kësaj kolegji konstaton se ankuesi është në punë të rregulltë pranë Qendrës Korrektuese në Lipjan, dhe se pretendimet ankimore të ankuesit sa i përket punës jashtë orarit të punës, sepse ankuesi nuk ka punuar jashtë orarit të rregulltë të punës, ashtu siç ka pretenduar ankuesi në ankesë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se jam i punësuar me orar punë dymbëdhjetë (12) orë punë nga ora shtatë (07:00) deri në orën njëmbëdhjetë zero (19.00) dhe se gjatë orarit të punës jemi të obliguar të punojmë jashtë institucionit Qendrën Klinike Universitarë të Kosovës, dhe gjatë kryerjes së detyrave bëjë orë jashtë orarit të punës , dhe se kam parashtruar kërkesë dhe se kam qenë i ngarkuar me veturë zyrtare dhe se të dhënat e dërguara nga Qendra e jonë në Drejtorinë Qendrore nuk janë të sakta, dhe se shumicën e rasteve kam qenë i ngarkuar me veturë zyrtare, ku janë evidentuar edhe kilometrat e veturës.

Për sqarimin e drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, administrative kolegji ka marr për bazë, e-mailin 18.03.2023, e dërguar nga Udhëheqësja e Njesisë për Punë Juridike dhe të Përgjithshme, e Qendrës Korrektuese të Kosovës është konstatuar ashtu siç ju njoftova edhe përmes telefonit ju konfirmoj edhe me shkrim që Zyrtari Korrektues Sabedin Veseli, asnjëherë nuk ishte përgjegjës për ngasjen e veturës për bartjen e stafit në QKUK -Prishtinë, kjo gjë është verifikuar edhe në bazë të listës se evitimit për ngasjen e veturave dhe evidentimi i kilometrave, andaj mbi bazën e kësaj kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë në kundërshtim me nenin 20, paragrafi 1 ,të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, ku përcaktohet se; **1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore, gjatë së cilës i punësuari kryen punë ose shërbime në të mirë të punëdhënësit, sepse ankuesi në Qendrën Korrektues në Lipjan, ka punuar me orarë pune të rregulltë, si dhe në kundërshtim me nenin 18, paragrafi 3 nen paragrafi 3 dhe neni 19, të Ligjit NR. 06/L -114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se; **3. Orët e punës të zyrtarëve publikë rregullohen sipas legjislacionit të punës Zyrtari publik ka****



të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave, sepse ankuesi nuk ka punuar jashtë orarit të punës ashtu siç ka pretenduar në ankesën e parashtruar në Këshill.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së përgjigjes në kërkesë të datës 20.04.2023, me numër protokoll 499, për ankuesin _____ ka vepruar në pajtim me dispozitat e të Ligjit NR. 06/L -114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me çështjen juridike sa i përket kërkesës çështjes juridike, për ankuesin Sabedin Veseli.

Prandaj, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.757/2023

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

